

# E ARDHMJA E SHQIPERISE

## Shqipëria bën prezantimin e parë në Komitetin për të Drejtat e Fëmijës



Foto: Arben Celi

Nxenesit e shkollës 9-vjeçare "Stavri Themeli" në Korçë duke ushtruar të drejtën e tyre për edukim.

Më 12 Janar Shqipëria bëri prezantimin e saj të parë në Komitetin për të drejtat e Fëmijës në Gjenevë. Prezantimi u bë pas dorëzimit të raportit të parë të Shqipërisë në Komitet, i cili është përgjegjës për të siguruar që vendet plotësojnë detyrimet e tyre që lindin pas ratifikimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën në vitin 1992.

Përfaqësuesja e UNICEF-it në Shqipëri, Carrie Auer u shpreh: "Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka bërë një progres domethënës lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve." Veprimet kundër trafikimit të fëmijëve, Kodi i Ri i Familjes dhe legjislacioni i drejtësisë për të rinjtë që është gati për t'u paraqitur përpara Parlamentit janë të gjitha arritje për t'u krenuar". Megjithatë, ka shumë për t'u bërë".

Në komentet e tij përmbyllëse, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës përshëndeti Shqipërinë për aprovimin e Kodit të Ri të Familjes në vitin 2003, për ngritjen e Komitetit Ndërmnistëror për të Drejtat e Fëmijës në vitin 2004, dhe për ratifikimin e dy konventave ndërkombëtare, njëra për punën e fëmijëve dhe tjetra për birësimin ndërshtetëror. Është vërejtur, gjithashtu, se Shqipëria vazhdon të përballet me sfida serioze politike, sociale dhe

ekonomike të imponuara nga periudha e tranzicionit, ku përfshihen nivelet e larta të papunësisë e të varfërisë dhe emigrimi i profesionistëve drejt vendeve të tjera duke e lënë vendin pa njerëzit e rinj aktivë që nevojiten, ku të gjitha këto ndikojnë në zbatimin e Konventës.

Gjatë vitit të kaluar UNICEF-i mbështeti Qeverinë në rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët, e cila u prezantua me datën 30 Maj, përpara Ditës së Fëmijëve. Një Plan Veprimi Kombëtar është aktualisht në hartim e sipër për zbatimin e strategjisë.

Komiteti për të Drejtat e Fëmijës funksionon nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo vend që ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijës ngarkohet me një detyrim ligjor për realizimin e të drejtave të kodifikuara në marrveshje dhe për raportimin sistematik pranë Komitetit se si janë duke u zbatuar të drejtat. Ky sistem i monitorimit të të drejtave të njeriut është i zakonshëm për të gjitha marrveshjet e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Për të plotësuar detyrimin e tyre për raportimin, shtetet duhet të raportojnë fillimisht dy vjet pas ratifikimit të Konventës dhe, pastaj, njëherë në çdo pesë vjet.

**Spektori privat  
mbështet përpjekjet  
e Shqipërisë  
kundër trafikimit  
të fëmijëve**

Faqe 2

**Histori të jetuara:  
Fitimi i përkrahjes  
për fëmijët  
dhe një jetë  
më e lumtur**

Faqe 2 - 3

**Përmirësimi i shërbimeve për të  
ndihmuar fëmijët e abuzuar**

Faqe 4

# Sektori privat mbështet përpjekjet e Shqipërisë kundër trafikimit të fëmijëve


Përsa i përket forcimit të aleancave me sektorin privat, UNICEF-i është lidhur me Vodafone për të mbështetur përpjekjet e qeverisë Shqiptare kundër trafikimit të fëmijëve. Kontributi domethënës nga Vodafone, i cili erdhi nëpërmjet Komitetit të Mbretërisë së Bashkuar për UNICEF-in, ka mbështetur zhvillimin e politikave, forcimin e bashkëpunimit me qeveritë e vendeve të tjera që lidhen nëpërmjet trafikimit, dhe mbështetjen e grupeve të shoqërisë civile që punojnë për të parandaluar trafikimin dhe për të integruar përsëri fëmijët që kanë qenë të trafikuar.

Kontributi ndihmon në mënyrë të veçantë punën e OJF-së vendase FBSH (Fëmijët e Botës dhe të Shqipërisë), e cila drejton aktivitetet për parandalimin e trafikut të fëmijëve në lagjet e varfëra të Tiranës. Puna e FBSH-së përfshin aktivitete për të ndihmuar fëmijët që rrezikohen të trafikohen; dhënien e ndihmës psikologjike për fëmijët nëpërmjet Qendrës Burimore të Komunitetit, nëpërmjet veprimeve siç janë grupet e diskutimeve javore me të rinjtë që nuk janë në shkollë dhe nëpërmjet inkurajimit të angazhimit prindëror në

aktivitetet e fëmijëve; integrimin të fëmijëve në shkollë nëpërmjet Projektit për Lagjen dhe Shkollat. Kjo përfshin integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta për mësim në klasat më lëndët e rregullta mësimore. Kjo përfshin edhe identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve që rrezikohen të trafikohen nëpërmjet bashkëpunimit me punonjësit socialë, drejtuesit e shkollave, zyrtarëve të njëjësive të qeverisjes vendore dhe me drejtorinë e arsimit.

Nafija është nëna e dy fëmijëve që marrin pjesë në projektin për lagjen. Ajo shprehet: “Tani jam më e vetëdijshme për rreziqet që i kanosen një fëmijë për t’u trafikuar”. “Punonjësit socialë po na ndihmojnë që të kuptojmë problemin”.

Kontributi ndihmoi edhe qeverinë në hartimin e projekt Planit Kombëtar të Veprimit kundër Trafikimit të Fëmijëve, i cili parashtron kuadrin për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe që respekton të drejtat e fëmijëve. Ai, gjithashtu, ndihmoi për krijimin e Grupit të Punës kundër Trafikimit të Fëmijëve të përbërë nga përfaqësues të ministrive kryesore dhe të prokurorisë.



Projekti inkurajon përfshirjen e prindërve në shkollë

U deshën 10 vite punë të lodhëshme dhe sakrificë që më në fund Shefikatja të arrinte të siguronte përkrahjen për katër fëmijët e saj. Dhe përveç përkrahjes për fëmijët, ajo mori edhe mësim të rëndësishëm që e kanë pasuruar jetën e saj.

Ajo pyet: “Doni të dëgjoni historinë time”? “Po, janë kujtime të këqija nga një martesë jo e lumtur, pasi unë jetova më një burrë të dhunshëm për tetë vite, dhe unë mund t’ju tregoj se jeta ime me atë ishte një ferr”.

## Histori të jetuara: Fitimi i përkrahjes për fëmijët dhe një jetë më e lumtur

Por më ndihmën e UNICEF-it Shefikatja arriti më në fund të shkojë në Gjykatë dhe të fitonte përkrahjen e detyrueshme ligjore për fëmijët. Shefikatja (mbiemri nuk është dhënë për të ruajtur

anonimitetin) ka qenë një punëtorë bujqësie dhe bashkëshorti i saj ka qenë minator. Ata jetonin në një zonë të varfër 20 km larg Tiranës. Rrudhat në fytyrë

(vijon në faqe 3)

*(vijon nga faqja 2)*


deshmonin për një jetë të vështirë e të trishtuar— si nga puna në arë, ashtu edhe nga të duruarit e një martesë të frikshme.

Ajo kujton: “Nuk kam për t’i harruar kurrë mbrëmjet kur bashkëshorti im vinte në shtëpi i pirë e rrihte fëmijet dhe mua”.

Në vitin 1993 ata vendosën të divorcohen. Ai e braktisi atë më të katër fëmijët nën 7 vjeç, duke përfshirë edhe dy binjakët në moshën një vjeç, në një shtëpi me një dhomë që kishte një çati që po binte. Gjatë stinës së shirave asaj i duhej t’i lëvizte fëmijët natën nga shtëpia me ndihmën e fqinjëve ose të afërmve të saj. Bashkëshorti saj nuk jepte asnjë lloj ndihmë për fëmijët. Ajo luftoi t’i rrsite ata me përkrahjen sociale prej 4,000 lekësh (\$40) në muaj, e cila gjithnjë shpëndahej me vonesë, ose shpesh nuk shpëndahej fare. Shpesh asaj i duhej të merre para borxh nga ndonjë shoqe apo nga e motra e saj. Ajo nxirrte ca të ardhura duke shitur rroba të përdorura në tregun e fshatit.

Shefikatja e dinte se asaj i takonte ligjërisht përkrahja për fëmijët, por ajo nuk dinte se nga të fillonte për ta fituar atë. Ajo e dinte se duhej t’i drejtohej gjykatës, por ajo nuk mund të përbalonte pagesën për një avokat apo kostot e tjera të procesit gjyqësor.

Në vitin 2003, Shefikatja dëgjoi rreth Qendrës Këshillimore për Gratë që ndeshen me Dhunën në Familje të mbështetur nga UNICEF-i, e cila ofron një numër shërbimesh për gratë në vështirësi. Ajo, gjithashtu, synon të japë aftësi dhe shembuj të roleve pozitive për të ndihmuar në krijimin marrdhënieve të respektit në familje, mbështetur në të vërtetën që fëmijët, të cilët shohin trajtimin e keq të nënës, marrin mësimin se ajo nuk meriton as respektin e tyre. Qendra jep këshillim paramartesor për çiftet e reja për t’i ndihmuar ata mbare. Ajo trajnon edhe këshillues të tjere për të punuar me gratë dhe vajzat që ndeshen me probleme në familje, ku deri tani janë trajnuar 80 persona dhe jep shërbime dhe rekomandime për gratë në raste të veçanta kur kane nevojë për



**Drita Babameto,**  
Koordinator e Qendres  
gjate nje seance  
keshillimi ne qender

ndihmë. Një aktivitet tjetër është nxitja e diskutimeve të komunitetit për krijimin e marrdhënieve të shëndetëshme familjare duke qenë një shembull i rolit të përshtatshëm për fëmijët dhe për dhënien fund të dhunës në familje. Këto seanca jozyrtare diskutimesh zhvillohen në shkolla të enjteve dite kur prindërit shkojnë të takojnë dhe të bisedojnë me mësuesit për ecurinë e fëmijëve të tyre.

Menjëherë sapo Shafikatja shkoi në qendër, asaj i rekomanduan të shkonte në Qendrën për Mbrojtjen e Grave, e cila i siguroi asaj një avokat që do ta ndihmonte falas për pesë seanca gjyqësore. Kjo i mundësoi asaj të bënte një kërkesë të suksesshme lidhur me fitimin e përkrahjes për fëmijët e saj nga ish-bashkëshorti.

“Në fillim unë nuk besoja se mund ta përfitoja një gjë të tillë, meqenëse kisha kohë të gjatë që prisja të kisha një

përkrahje për fëmijët e mi,” shprehet ajo, duke buzëqeshur “Por tani, falë ndihmës së qendrës, problemi është zgjidhur”.

Shefikatja nuk ishte në dijeni të të drejtave të shprehura në Kodin e Ri të Shqipërisë për Familjen. I rishikuar në vitin 2003, ai përfshin përmirësime domethënëse në funksion të statusit të grave dhe të fëmijëve. Ai rrit moshën e martesës për vajzat nga 16 në 18 vjeçe dhe përkufizon më mirë përgjegjësitë për rritjen e fëmijës dhe të drejtat ekonomike në rastet e divorcit. Kodi përfshin edhe masat e emergjencës për viktimat e dhunës në familje.

Koordinatorja e qendrës, Drita Babameto shprehet: “Nuk ka informacion për këtë ligj të ri, dhe është e rëndësishme të publikohet për të rritur kërkesën për njohjen e dispozitave të tij”. Vetëm në një vit, Qendra ka informuar 2,000 persona, kryesisht gra e vajza për probleme të tilla siç është angazhimi i komunitetit dhe ndihma shëndetësore e psikologjike.

“Më kujtohet se sa e frikësuar ishte Shefikatja në fillim,” thotë zonja Babameto. “Kur ajo dëgjoi për qendrën, ajo nuk pati shumë besim të bashkohej me ne dhe të kërkonte këshilla, pasi mentaliteti në komunitetin e saj është shumë patriarkal. Po tani unë mund të shoh se sa shumë ka ndryshuar ajo”.

Shefikatja e viziton shpesh qendrën, duke pasur kënaqësinë e shoqërisë me gratë që mbështesin njëra-tjetrën për trajtimin e problemeve të tyre. Ajo çfarë ka mësuar në qendër i ka mundësuar asaj të mësojë fëmijët e saj që të respektojnë veten e tyre dhe të bëhen qytetarë të përgjegjshëm. Ajo dhe katër fëmijët e saj jetojnë sëbashku në shtëpinë e tyre në paqe e harmoni, dhe ajo ka gjetur më shumë qetësi në veten e saj. Vajza e saj e madhe është fejuar tani kohët e fundit dhe ka gjetur një punë.

“E keqja ka kaluar,” thotë Shefikatja. “Tani fëmijët e mi po rriten, kanë arritur të mbarojnë të paktën shkollën fillore, dhe po ndihmojnë njëri-tjetrin. Unë shpresoj se ata do të kenë një jetë më të mirë se e imja, dhe unë shpresoj se i kam mësuar se si të kenë dashuri dhe respekt për veten e tyre dhe për familjët e tyre të ardhshme”.

# Përmirësimi i shërbimeve për të ndihmuar fëmijët e abuzuar



Nxenesit e shkolles "Skenderbej" ne Elbasan duke mesuar per zgjidhjen paqesore te konflikteve

## Nga Ditika Shehi Koordinatorë, MCMCM

Dhuna në familje kundër grave dhe fëmijëve vazhdon të tolerohet në marrdhëniet shoqërore në Shqipëri. Ndonëse ka vetëm pak statistika të besueshme lidhur me numrin e viktimave të këtij krimi të fshehur, organizata jonë, Qendra Shumëdisiplinore për Manaxhimin e Keqtrajtimit të Fëmijëve, bëri një anketim të fëmijëve në Tiranë dhe në rrethinat e saj në vitin 2002 për të përcaktuar ekspozimin e fëmijëve ndaj dhunës. Anketimi, në të cilin u përfshinë 1,000 fëmijë nga moshën 6 deri në 18 vjeç gjeti si më poshtë vijon:

\* 73 përqind e fëmijëve u shprehën se kishte keqtrajtim të fëmijëve në shkollë

- \* 58 përqind e fëmijëve të moshës 6 - 18 vjeç u shprehën se ata kishin përjetuar abuzim emocional nga një prindër i familjes
- \* 41 përqind u shprehën se nëna e tyre abuzonte emocionalisht me ata dhe 17 përqind u shprehën se ata kishin përjetuar abuzim emocional nga babai i tyre
- \* 36 përqind u shprehën se nëna e tyre abuzonte fizikisht me ata dhe 22 përqind u shprehën se kishin përjetuar abuzim fizik nga babai i tyre
- \* 23 përqind u shprehën se babai i tyre përdorte alkool, gjë e cila shkaktonë grindje ndërmjet prindërve si edhe abuzim me fëmijët
- \* 11 përqind u shprehën se ata kishin përjetuar ngacmim seksual, ku rreth 4 përqind e tyre e kishin përjetuar atë në ambjentin e tyre familjar

Organizatat qeveritare dhe joqeveritare Shqiptare kanë ndërmarrë veprime për të ulur dhe për të parandaluar dhunën në familje dhe abuzimin e fëmijëve. Por mbetet akoma shumë për t'u bërë. Për shembull, në Shqipëri mungojnë strukturat e specializuara, siç janë zyrat e referencës për t'u marrë me mbrojtjen e fëmijëve në mënyrë gjithpërfshirëse brenda institucioneve qeveritare vendore si dhe kordinimi e monitorimi.

Qendra jonë në Tiranë, e mbështetur nga UNICEF-i, hartoi një plan veprimi për të përmirësuar shërbimet për fëmijët e abuzuar. Bashkitë e Elbasanit dhe Shkodres u zgjodhën si bashki pilot për shërbimet që do të shtriheshin tek këta fëmijë.

Në mënyrë që një qendër e tillë të ketë ndikim në jetën e fëmijëve, strukturat e shtetit duhet të jenë të përgatitura për të sjellë kuadrin e veprimit dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e aktiviteteve. Prandaj bashkëpunimi shumë i fortë me qeverisjen vendore

përbën një prioritet. Diskutimet e gjëra që u bënë me zyrarët e qeverisjes vendore në Elbasan dhe në Shkodër i ndihmuan ata të njohin përmasat e problemit të dhunës kundër fëmijëve. Bashkitë dhuruan një zyrë dhe një anëtarë të stafit për të koordinuar punën dhe për të raportuar mbi situatën. Ndërmjet MCMCM-se dhe dy bashkive Elbasan dhe Shkodër u nënshkrua një memorandum mirëkuptimi, i cili çoi në bashkëpunimin e parë me qeverisjen vendore.

Përvoja jonë na ka mësuar që mobilizimi i komunitetit është kyçi i suksesit. Kështu, shumica e kohës tonë i dedikohet rritjes së ndërgjegjësimit ndërmjet qytetarëve për të parandaluar dhunën në familje dhe për të mbrojtur fëmijët nga pasojat e abuzimit. Qendra ka shpërndarë shumë materiale informative rreth problemeve të abuzimit të fëmijëve dhe të dhunës në familje dhe ka organizuar aktivitete edukuese me prindërit. Kjo përfshin aktivitetet që ndihmojnë fëmijët për të zhvilluar dhe për të rritur aftësinë e zgjidhjes së problemeve dhe të konflikteve si dhe fushatë me komunitetin lidhur me abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje.

## **Deri tani në Elbasan e Shkodër**

- \* 18,630 studentë kanë mësuar rreth alternativave paqësore për zgjidhjen e konflikteve
- \* 1,980 prindër janë sensibilizuar për abuzimin e fëmijëve dhe neglizhimin brenda familjes
- \* 594 mësues dinë se si të identifikojnë fëmijët që janë abuzuar dhe si të udhëzojnë prindërit për të përfituar të drejtën e marrjes së shërbimeve
- \* 330 fëmijë viktime të abuzimit u është dhënë asistencë psikologjike nga specialistët

Shkollat janë shumë të rëndësishme për parandalimin e dhunës, prandaj ne përkrahim trajnimin e mësuesve për parandalimin e saj dhe për të ndërhyrë kur është e nevojshme.

## **KONTAKT MCMCM:**

Web site: [www.mcmcm.org](http://www.mcmcm.org)  
Email: [chabuse@alabniaonline.net](mailto:chabuse@alabniaonline.net)  
Telefoni: 267038, 230820